

ÇËSHITJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 2, dimër 2006

PËRMBAJTJA

Bordi botues	
I llyrje	7
Introduction	7
Deklarata e Samitit të NATO-s në Rige	11
Direktiva e përbashkët politike	29
Gjeneral Lejtnant (Rez) Pëllumb Qazimi	
Samiti i NATO-s në Rige dhe identiteti i Forcave të Armatosura Shqiptare	38
Anthony Cleland Welsh	
Aritja e sigurisë tjerëzore pas konfliktit brendshkëtonor: Mësimet e fituara në Kosovë	45
Prof. Dr. Rexhep Meidani	
Probleme të sigurisë tjerëzore në Ballkanin Perëndimor	78
Prof. Dr. Aurela Anastasi	
Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore, si garanci reale për sigurimin e zbatimit dhe respektimit të tyre	93
Kol (R) Dr. Arshi Çeta	
Përgjegjësi qytetare në çështjet e sigurisë	104
Sten Rynning	
NATO-ja e riuotuar	110

Bordi botues:

Kryetar

Gj. Li, (rez.) Pëllumb Qazimi

Anëtarë

Prof. dr. Dhoni Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Agn Verrilja – Këshilltar i Kryeministrit

Sotiraj Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndemetësim

Konsulentë

Geron Kambur – M.A. në Studime Evropiane

Artan Kanni – M.A. në Administrim Publik

Redaktor Përgjegjës

Enis Subarova – M. Sc. Shkencë Politike dhe Administrim Publik

*Ky numër i revistës botohet me mbështetjen financiare
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel dhe
te Albanian Mobile Communications (AMC)*

Franko Egro "Dyluftimi" brenda NATO-s	117
David Low Qeverisja e Sektorit të Sigurisë në Strategjinë e Zgjerimit të BE-së	124
Prof. dr. Gjergj Sinani Projektet për Europën dhe Europë reale	142
Revista e NATO-s: Përmbledhjet e artikujve të vitit 2006	155
English Summary	178

David Law

QEVERISJA E SEKTORIT TË SIGURISË NË STRATEGJINË E ZGJERIMIT TË BE-SË

Shkurtime:

- * RSS - Reforma e Sektorit të Sigurisë
- * QSS - Qeverisja e Sektorit të Sigurisë

Hyrje

Qëllimi i këtij artikulli është që të diskutojë mbi konceptin e qeverisjes së sektorit të sigurisë (QSS) në kontekstin e *Strategjisë së Zgjerimit të BE-së dhe Sfidave Kryesore 2006-2007* të miratuara nga Komisioni Europian në 8 Nëntor 2006. Ai merr në shqyrtim faktin se përse qeverisja demokratike e sektorit të sigurisë është e rëndësishme për vendet e Ballkanit Perëndimor, se si ky element mund të përfshihet më mirë në politikën e Zgjerimit të BE-së dhe çfarë do të thotë në termat e kushtëzimit për sa i përket anëtarësimit në Bashkimin Europian. Pjesa e parë jep një përshkrim të shkurtër të reformës dhe qeverisjes së sektorit të sigurisë, ofron një model të përgjithshëm të një sektori sigurie, rivlerëson arsyet e ndryshme se përse një vend ka nevojë për një sektor sigurie funksional si dhe shpjegon gjithashtu se përse është veçanërisht me rëndësi të posaçme për vendet e Ballkanit Perëndimor, si vendet e para post-konfliktuale që janë përfshirë në procesin e zgjerimit. Në pjesën e dytë identifikohen reformat dhe aktivitetet e ndryshme që lidhen me reformat në sektorin e sigurisë të Bashkimit Europian, duke i kushtuar vëmendje të veçantë koncepteve të Komisionit dhe Këshillit Europian, për sa i përket reformave në sektorin e sigurisë që janë miratuar në 2005-2006. Përkundër këtij sfondi, propozohen tre ide se

si Bashkimi Europian duhet të ecë i mbështetur në drejtimet kryesore të reformave në sektorin e sigurisë në lidhje me politikën e tij të zgjerimit.

Një nga ato është që ta bëjë *Strategjinë e Zgjerimit të Bashkimit Europian* më koherente me koncepte të Komisionit dhe të Këshillit Europian, që lidhen me reformat në sektorin e sigurisë (RSS), të cilat paraqesin një këndvështrim të gjerë të këtij sektori.

Një ide e dytë është ajo për të përdorur pikat orientuese për të arritur një përputhshmëri më të madhe, forcimin e mirëbesimit në vendimmarrje, menaxhim më efektiv të burimeve si dhe koordinim mes institucioneve.

Një ide e tretë është që të rrisë kapacitetin e BE-së në Reformën e Sektorit të Sigurisë nëpërmjet rryeteve të bashkëpunimit. Ky prezantim arrin në përfundimin se Qeverisja e Sektorit të Sigurisë (QSS) nuk është një kushtëzim i ri, por më shumë është një rivlerësim se çfarë do të thotë kushtëzim qëkur se kushtet kanë ndryshuar prej miratimit të kriterëve të Kopenhagenit për anëtarësim në BE në vitin 1993.

Pjesa I:

Reforma në Sektorin e Sigurisë (RSS) dhe Qeverisja e Sektorit të Sigurisë (QSS) si dhe rëndësia e tyre për Ballkanin Perëndimor

Termet e Referencës:

Çfarë është Sektorin e Sigurisë?

Sektorin e Sigurisë nënkupton të gjitha grupet në shoqëri që janë të afta për të përdorur forcën, po ashtu si edhe institucionet që i administrojnë, drejojnë, mbikëqyrin dhe i kontrollojnë ato, apo që luajnë një rol në zhvillimin e politikës së sigurisë së një vendi dhe ofrojnë sigurinë për të.

Çfarë është Qeverisja e Sektorit të Sigurisë ?

QSS-ja lidhet me strukturat, proceset, vlerat dhe qëndrimet që formojnë vendimet rreth sigurisë dhe zbatimin e tyre.

Çfarë është Reforma e Sektorit të Sigurisë ?

RSS-ja ka për qëllim forcimin e QSS-së nëpërmjet shpërndarjes efektive e të saktë të sigurisë në një mjedis, i cili është pjesë e mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik.

Nëse qeverisja e sektorit të sigurisë u drejtohet strukturave, vlerave dhe qëndrimeve që formojnë vendimet rreth sigurisë dhe zbatimit të tyre, reforma e sektorit të sigurisë është një mënyrë e rritjes në një shkallë sa më të lartë të qeverisjes në sektorin e sigurisë. Ajo nënkupton që siguria duhet të kuptohet dhe të realizohet në mënyrë sa më të drejtë. Ajo ofron një *metodologji* për të fuqizuar sa më shumë burimet e sigurisë dhe jep një *kuadër* për të përkufizuar se cilët aktorë e faktorë janë më rëndësia për sigurinë.

RSS-ja, teksa këmbëngul mbi nevojën për një drejtim sa më gjithëpërfshirës e të kuptueshëm, ajo arrin të mbledhë së bashku një rrjet të ndryshëm, shpesh po aq të palidhur të aktorëve, interesave që i përkasin:

1. Rrjetit të juridiksionit dhe grupeve të përfshira në shpërndarjen e sigurisë dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.
2. Iniciativave të donatorëve për ndërtim kapacitësh apo qeverisje të mirë.
3. Plan-programeve të organizatave ndërqeveritare që ushtrojnë aktivitet në fusha të tilla të politikës që janë sa tradicionale po aq edhe të palidhura si p. sh. qeverisja për zhvillim dhe siguria.
4. Programeve kombëtare, rajonale, ndërrajonale, apo ndërkombëtare
5. Aktiviteteve qeveritare e joqeveritare.
(skica)

Siç e treguam edhe më lart sektori i sigurisë përbëhet nga 7 grupe:


- Forcat dhe rregullat e sigurisë
- Autoritetet ekzekutive dhe ato të administrimit civil
- Kontrolli legjislativ i sektorit të sigurisë
- Institucionet gjyqësore dhe ligjore që kontrollojnë nëse forcat e sigurisë dhe ministritë e fuqishme janë duke respektuar kushtetutën dhe të drejtat e njeriut.
- Shoqëria civile dhe organizatat joqeveritare
- Forcat jo të rregullta të sigurisë dhe
- aktorët e jashtëm


Ky është një këndvështrim i gjërë për sektorin e sigurisë pasi ai përfshin grupe dhe juridiksione që nuk janë parë gjithmonë si pjesë e tji, p. sh.:

- Ministritë që nuk kanë qenë tradicionalisht të përfshira në çështjet e sigurisë, duhet të fillojnë të marrin një rol plotësues në këtë fushë si rezultat i ndryshimeve në atë që quhet "hapësirë e kërcënimeve": p. sh. Ministria e Bujqësisë, e Transporteve apo e Shëndetësisë.
- Partitë politike me kapacitetin e tyre si institucione që zhvillojnë politika për sektorin e sigurisë.
- Komuniteti i biznesit në aspektin e roleve të ndryshme që ai luan në sektorin e sigurisë.

Ndërkohë një qasje e ngushtë për sektorin e sigurisë mund të synojë shmanjen apo lënien jashtë vëmendjes të forcave jo të rregullta të sigurisë apo të zvogëlojë përmasën e qeverisjes së këtij sektori.

Pozicioni i çdo aktori në një sektor sigurie standard





Pse një vend ka nevojë për një sektor sigurie funksional?

Një sektor sigurie funksional është i rëndësishëm për një numër arsyesh.

Siguria Njerëzore dhe të Drejtat e Njeriut

Nga një perspektivë e reformës në sektorin e sigurisë, siguria është së pari dhe mbi të gjitha e përqendruar në mbrojtje të shoqërisë dhe vetëm si funksion i kësaj edhe i shtetit. Një shtet nuk do të ishte në gjendje të ofronte nivele të pranueshme të sigurisë njerëzore për popullsinë e tij dhe të mbronte të drejtat e tyre njerëzore, derisa sektori i tij i sigurisë të jetë i aftë të veprojë në mënyrë efektive dhe në kushtet e një kontrolli demokratik.

Sundimi i ligjit

Për t'u siguruar se rregullat e shoqërisë respektohen, nevojitet një aftësi zbatuese e ligjit që është/duhet të jetë qoftë efektive, por edhe e drejtë.

Zhvillimi

Reforma në sektorin e sigurisë ka për qëllim të arrijë që këtyrë sektori t'i caktohet një nivel i përshatshëm burimesh; gjithashtu më shumë burime nënkuptojnë që rezultatet e rëndësishme për zhvillimin ekonomik rrjedhin nga ky qëllim; në të njëjtën më pak burime do të thotë që sektori i sigurisë nuk është në gjendje të ofrojë mbrojtjen dhe stabilitetin e nevojshëm për zhvillimin dhe rritjen.

Demokratizimi/demokracia

Një sektor sigurie funksional është parakusht për zhvillimin demokratik; nëse sektori i sigurisë është jofunksional, zhvillimet demokratike mund të vonohen, të shmangen ose të kthehen mbrapsht. Një demokraci e zhvilluar, sektori i sigurisë i së cilës është jo funksional, rrezikon *zhdemokratizimin*.

Stabiliteti rajonal

Një sektor sigurie jofunksional në një vend mund të destabilizojë zhvillimet në rajonin e tij. Në të njëjtën kohë, reforma në sektorin e sigurisë e realizuar në një nivel të gjerë rajonal mund të mosë mirëbesimin ndërmjet fqinjëve; një qasje rajonale për reformën në sektorin e sigurisë mund të mbështesë përpjekjet për reformën në nivel kombëtar.

Integriteti

Ashu siç theksohet në proceset e zgjerimit të NATO-s dhe BE-së, një konsideratë kyçe në vendimet rreth anëtarësimit është mënyra se si mbështetet dhe funksionon sektori i sigurisë


së vendit aplikant. Në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo, kushtëzimi që lidhet me sektorin e sigurisë ka qenë një faktor i përhershëm që nga përcaktimet e përgjithshme mbi qeverisjen demokrautike të institucioneve të formuluara në kriteret e Kopenhagemit të 1993, nëpërmjet tyre apo edhe përtej Planit e Veprimit për Anëtarësim të NATO-s (MAP).

Ndarja e Përgjegjësiave

Në një mjedis global të sigurisë, shtetet duhet të jenë në gjendje që të kontribuojnë në përpjekjet globale e rajonale për të parandaluar konfliktin si dhe për të rivendosur e mbrojtur paqen. Kjo kërkon një përgjigje të gjerë e të përbashkët të të gjitha shteteve me vetëdije solidariteti e përgjegjëshmëti si dhe një sektor sigurie funksional, që është në gjendje të plotësojë këtë shkallë përgjegjësi.

Të gjitha këto këshilla janë veçanërisht të rëndësishme dhe përbëjnë një sfidë më vete për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe anëtarësimin e tyre të pritshëm për në BE.

Zgjerimet e BE-së



Të gjitha zgjerimet e mëparshme të BE-së kanë sjellë me vete probleme të veçanta, p. sh.:

- Zgjerimi i parë në Europën Perëndimore duhet të përballej me marrëdhëniet e kandidatëve me kolonitë dhe ish-kolonitë dhe rivalitetet ndërmjet shteteve më të fuqishme të Europës.
- Zgjerimi i dytë solli në BE shtetet e Europës perëndimore që kishin përjetuar eksperiencën të sundimit autoritar pjesërisht apo tërësisht gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.
- Vala e tretë solli shumicën e shteteve neutrale të Europës dhe çështjen se si statusi i tyre do të lidhej me BE-në duke ndryshuar më pas politikën e sigurisë e të mbrojtjes.
- Zgjerimi i katërt solli shtetet e para post-komuniste, të cilat ishin në një shkallë të madhe akoma nën procesin e reformave ekonomike, politike dhe transformimit social dhe në raste të caktuara duhej të përballeshin me çështjet e krijimit apo rikrijimit të shtetit të tyre.
- Zgjerimi i pestë në Ballkanin Perëndimor do të sjellë shtetet e para post-konfliktuale, të cilat janë në të njëjtën kohë post-komuniste dhe të formuara rishtazi.

Këto grupime nuk ishin kaq të ndara sa ofrohet nga ky karakterizim; shpesh shtete të natyrave të ndryshme janë përfshirë në të njëjtën valë zgjerimesh – ashtu si në mënyrë të ngjashme, zgjerimi i fundit solli si shtete post-komuniste ashtu si edhe neutrale brenda BE-së.

E përmendëm të gjithë këtë fakt për të treguar se zgjerimi në Ballkanin Perëndimor është në një sërë aspektesh unik dhe kërkon disa çasje të veçanta, veçanërisht për sa i përket mënyrës se si trajtohet sektori i sigurisë si pjesë e procesit të zgjerimit. Një numër problemesh, apo *sëmundjesh* qëndrojnë përpara:

- Sektori i sigurisë ka shumë më tepër autoritet për shkak të rolit të tij në konflikt.
- Sektori i sigurisë nuk mbikëqyret në mënyrë demokrautike për shkak të dobësisë së përgjithshme të qeverisjes demokrautike.

- Sektori i sigurisë është i diskredituar për një pjesë të popullatës për shkak të rolit të tij në konflikt dhe mund të shihet si kërcënim i sigurisë me vetë të drejtat e tij.

Sektori i sigurisë praktikisht nuk ekzistonte përpara konfliktit dhe duhet të ngrihet nga rreënojat.

Pjesa e II:


RSS-ja, QSS-ja në Politikën e Zgjerimit të BE-së

RSS-ja në fushat e politikës së BE-së

Në vitet e kaluara, Komisioni dhe Këshilli Europian kanë hartuar koncepte më vete për RSS-në, po ashtu si edhe një kuadër të përgjithshëm qeverisës për RSS-në e BE-së si një të tërë. Si pjesë e këtij procesi, Këshilli dhe Komisioni kanë treguar se RSS-ja është e rëndësishme për një sërë fushash të politikës së BE-së.

Në Rastin e Këshillit, fushat kyçe të politikës në mënyrë të qenësishme lidhen me aktivitetet që ndërmerren nën *Politikën e Përbashkët për Sigurinë dhe Punët e Jashtme* (CFSP-Common Foreign Security and Policy) dhe veçanërisht misionet administruese të krizave ushtarake e civile në kuadër të *Politikës Europiane për Sigurinë e Mbrojtjen* (ESDP-European Security and Defence Policy). Për Komisionin janë 6 fusha të rëndësishme të kësaj politike që lidhet me reformën e sektorit të sigurisë:

1. Politika Europiane e Fqinjësisë-ENP (European Neighborhood Policy)
2. Bashkëpunimi për Zhvillimi (DC - Development Cooperation)
3. Parandalimi i konfliktit dhe menaxhimi i krizave
4. Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut
5. Aspekti jashtë BE-së i Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë dhe sigurnisht
6. Zgjerimi/Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit



Strategjia e zgjerimit & sfidat e reja 2006-2007:
Përbërësit e qeverisjes së sektorit të sigurisë

Lidhjet

Për sa i përket lidhjeve, BE-ja mund të dojë rishqyrtimin e mënyrës se si janë pasqyruar referencat ndaj QSS-së në raportet e strategjisë së zgjerimit. Në materialin e mëposhtëm, referencat ndaj RSS-së në Raportin e Zgjerimit 2006-2007 kanë qenë të grupuara në tre kategori: *sfidat e sigurisë, aktorët e sigurisë dhe administrimi e kontrolli i sigurisë*.

Në fakt, në raport këto referenca janë kretësisht të palidhura. Ky është një pasqyrim logjik i mënyrës se si BE-ja është vetë e organizuar së brendshmi. Megjithatë, një mënyrë duhet të gendet për t'i përfshirë ato së bashku si një tërësi strukturash të ndërlidhura ndërmjet tyre, aje ku është e qartë, p. sh. ajo që merret me ato që kërkon terrorizmi:

- Kapacitete të ndryshme mbi një pjesë të forcave të sigurisë.
- Paradigma të reja në mënyrën se si siguri të ndryshme ofrojnë të punojnë së bashku dhe me aktorë të tjerë, qoftë brenda vendit apo qoftë edhe në kontekstin rajonal apo ndërkombëtar si dhe,
- Forcimi i mekanizmave të kontrollit/mbikëqyrjes.

Në mënyrë të ngjashme trajtimi i çështjes së kriminelëve të luftës në Ballkan nuk është vetëm një sfidë e *gjurmimit, kapjes e burgosjes*, por përfshin edhe aspekte të kapacitetit dhe mbi të gjitha të kontrollit demokratik.

ADMINISTRIMI & KONTROLLI I SIGURISË <ul style="list-style-type: none"> · Kontrolli Parlamentar · Kapaciteti administrues i ekzekutivit · Mbështetja dhe funksionimi i gjyqësorit · Funksionaliteti i shoqërisë civile · Ndërveprimi i aktorëve të sigurisë · Bashkëpunimi rajonal 	SFIDAT E SIGURISË <ul style="list-style-type: none"> - Terrorizmi - Korrupsioni - Trafikimi - Krimi i Organizuar - Pjesëmarrja në misionet e ESDP-së - Bashkëngjitja në CFSP
	OFRUESIT E SIGURISË <ul style="list-style-type: none"> - Politika e jashtme - Policia - Mbrojtja - Administrimi i Kufijve - Shërbimet Informative

ESDP - Politikat Europiane të Mbrojtjes dhe të Sigurisë.

CFSP - Politika e Përbashkët në Çështjet e Jashtme dhe ato të Sigurisë.

Strategjia e Zgjerimit & Sfidat e Reja 2006-2007:
Përbërësit e QSS-së

Administrimi & Kontrolli i Sigurisë

- Kontrolli parlamentar
- Kapaciteti administrues i ekzekutivit
- Mbështetja e funksionimi i sektorit gjyqësor
- Funksionaliteti i shoqërisë civile
- Ndërveprimi i aktorëve të sigurisë
- Bashkëpunimi rajonal

Pikat e Orientimit

Një ide e dytë për sa i përket integritetit të QSS-së në politikën e zgjerimit është nocioni i benchmarking/orientimit siç rekomandohet në vetë qasjen e BE-së dhe tashmë së fundi edhe në Dokumentin e Strategjisë së Zgjerimit 2006-2007.

Pikat e orientimit mund të kenë përparësi të shumta për fusha që lidhen me:

- Pika orientuese - me kushtin që ato të jenë të hartuara në mënyrë shumë të qartë - mund të ndihmojnë vendet kandidatë në përpjekjet e tyre për të plotësuar standardet e BE-së dhe mbi të gjitha të ndihmojnë vetë BE-në për të drejtuar shqetësimet e saj lidhur me zbatimin e tyre.
- Një grup i përbashkët pikash orientuese do të lejojte për një krahasueshmëri më efektive rreth zgjerimit, të cilat mbi të gjitha do të përforconin kohëzotimet e vetë këtij procesi.
- Një proces orientimi - duke supozuar që ato të administrohen në mënyrë transparente - mund të ngrejë çështjen për BE-në në pikëpamjet e theksit që ai ka vënë mbi komunikimin siç ecën procesi i zgjerimit.
- Orientimi do të lehtësonte gjithashtu planifikimin financiar qoftë në Bruksel apo në vendet kandidatë.
- Pikat orientuese të BE-së mund të vendosin faza për institucionet e tjera duke zhvilluar udhëzimet dhe standardet e tyre dhe në proces inkurajojnë mundësisht përpjekjet për të krijuar standarde të përbashkëta përgjatë institucioneve.

Qeverisja Demokratike e Sektorit të Sigurisë

Janë më poshtë 10 norma kyçe për qeverisjen demokratike të sektorit të sigurisë që mund të jenë të dobishme në zhvillimin e atyre pikave orientuese të përmendura më sipër. Ato janë pika orientimi të një sektori sigurie ideal që nuk janë gjëkundi të realizuar në praktikë, por ato mund të jenë akoma


të dobishme për ta drejtuar BE-në dhe përpjekjet e partnerëve për të krijuar grupin e tyre të pikave të orientimit.

1. Forcat e sigurisë janë të afta të ofrojnë siguri në mënyrë efektive dhe me një kosto të arsyeshme.
2. Forcat e sigurisë janë përfaqësuese të popullatës.
3. Forcat e sigurisë veprojnë në mënyrë transparente.
4. Objektivat dhe politikat e sigurisë së një vendi janë të vendosura në kuadër të një strategjie kombëtare të sigurisë, që përcakton detyrat respektive dhe përgjegjësitë e aktorëve të sigurisë.
5. Autoritetet e administrimit civil, që janë përgjegjës për forcat e sigurisë, janë të aftë t'u japin forcat e sigurisë drejtimin e duhur.
6. Forcat e sigurisë kontrollohen dhe përgjigjen ndaj autoriteteve të ngritura në mënyrë demokratike, në veçanti legjislativi ka fuqinë dhe aftësinë për të kontrolluar politikat dhe aktivitetet e forcave të sigurisë si dhe të autoriteteve civile që i administrojnë dhe i drejtojnë ata.
7. Sektori i sigurisë udhëhiqet nga një kuadër i rreptë ligjor dhe juridik.
8. Shoqëria civile dhe aktorët joqeveritarë me një rol në fushën e sigurisë janë të pavarur dhe aktivë.
9. Aktorët vendas të sektorit të sigurisë janë të aftë të ndërveprojnë me njëri-tjetrin.
10. Veprimtaria e aktorëve vendas të sigurisë është e integruar në mënyrë efektive në kuadrin rajonal e ndërkombëtar të sigurisë.

Ofruesit e Reformës në Sektorin e Sigurisë në Bosnje*Krijimi i rrjeteve*

Një ide e tretë i përket rritjes së kapaciteteve nëpërmjet krijimit të rrjeteve. Diagrami i mëposhtëm paraqet aktorët e jashtëm kryesorë, të përfshirë në reformën e sektorit të sigurisë në Bosnje. Është e rëndësishme që të arrih bashkimin e këtyre aktorëve për të mbështetur punën e Zyrës së Komisionit në

fushën e RSS-së, në veçanti veprimtaritë e BE-së për të zbatuar strategjinë e saj të RSS-së dhe rolit të përfaqësuesve të zyrës së saj lokale që po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në proces.



Pjesa e III: Termat e kushtëzimit

Për t'u bashkuar BE-së, një shtet i ri anëtar duhet të përmbushë tre kritere:

1. Politik – stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektin e mbrojtjen e minoriteteve.
2. Ekonomik – ekzistencën e një ekonomie funksionale tregu dhe kapacitetin për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së.

3. Pranimin e *acquis communautaire* – legjislacionin e BE-së: aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë edhe besimin ndaj qëllimeve politike, ekonomike e bashkimit monetar.

A përfaqëson QSS-ja një kushtëzim të ri? Fjala siguri nuk përmendet në kriteret e Kopenhagemit, të miratuar 13 vjet më parë dhe të cituar më sipër. Kjo është e kuptueshme.

Në këtë pikë:

- Ndryshimi i të kuptuarit tonë mbi mjedisin e sigurisë në post-luftën e ftohtë ishte akoma në hapat e tij të parë.
- BE-ja vetë sapo kishte filluar të zhvillonte një identitet të sigurisë dhe,
- Nuk ishte akoma e qartë se sa të rëndësishme ishin për demokratizimin çështjet e kontrollit demokratik të sektorit të sigurisë.

Më tej, të tre elementët e kushtëzimit kanë një përmasë të QSS-së.

1. Kushtëzimi demokratik përfshin kontrollin demokratik të sektorit të sigurisë.
2. Nuk mund të ketë një ekonomi tregu funksionale pa një sektor sigurie, që funksionon dhe mbështetet; megjithatë një sërë kriteresh që janë nën kushtëzimin ekonomik kanë të bëjnë drejtpërdrejt me sektorin e sigurisë, p. sh. regjimet kufitare dhe doganore.
3. *Acquis* duhet të përfshijë një numër të gjerë dispozitash ligjore në fushën e Drejtësisë e të Punëve të Brendshme.

Në këtë mënyrë QSS-ja nuk është një kushtëzim i ri; më shumë ajo është një rishqyrtim se çfarë nënkupton kushtëzimi në kushtet e ndryshuara. Fakti që ky kushtëzim është duke u bërë më i strukturuar dhe më i qartë është një përfundim për të gjithë.

David Lau është Senior Fellow në Qendrën e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).